



RREGULLORE E ANËTARËSISË

Kjo rregullore është përpiluar në pajtim me Statutin e *Institutit të Kosovës për Politikat Evropiane*.

Neni 1-Qëllimi

- 1.1. Qëllimi i kësaj rregullore është të rregullojë anëtarësimin në Kuvendin e Anëtarëve.
- 1.2. Rregullorja përcakton procedurat e anëtarësimit, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, pushtetet për anëtarësim dhe për largim, rolin e anëtarëve dhe elemente të tjera të nevojshme për një anëtarësi funksionale.

Neni 2 - Procedura e Anëtarësimit

- 2.1. Të drejtë anëtarësimi në Kuvendin e Anëtarëve të organizatës kanë të gjithë personat, pa dallim feje, përkatësie etnike ose fetare, orientimi seksual e politik, bindje politike dhe filozofike ose/dhe gjinisë.
- 2.2. Nuk do të ftohen në organizatë personat të cilët kanë histori kriminale, nuk respektojnë të drejtat e njeriut dhe janë anëtarë të organizatave ilegale.
- 2.3. Një person i cili dëshiron të jetë anëtarë i organizatës ai ose ajo duhet të paraqet një kërkesë me shkrim që i drejtohet organizatës, ku shprehin dëshirën për anëtarësim dhe arsyet.
- 2.4. Kërkesa e parashtruar shqyrtohet në mbledhje të Kuvendit të Anëtarëve, ku anëtarësimi garantohet me shumicë votash të anëtarëve prezent. Vendimi për kërkesën i drejtohet personit në fjalë dhe evidentohet në procesverbal.

Neni 3 - Shkarkimi

- 3.1. Shkarkimi i anëtarëve të organizatës bëhet në këto raste:
 - 3.1.1. Anëtari dënohet për vepër penale,
 - 3.1.2. Nëse shkel Kodin e Mirësjelljes,
 - 3.1.3. Nëse shkarkohet nga vendi i punës,
- 3.2. Vendimin për shkarkimin e merr Kuvendi i Anëtarëve me shumicë të votave të anëtarëve prezent.
- 3.3. Një kopje e vendimit i dërgohet anëtarit paraprak.

Neni 4 - Kufizimet e Anëtarëve

- 4.1. Anëtari nuk mund të përfaqësojë organizatën pa autorizimin e organizatës
- 4.2. Anëtari nuk mund të bëjë deklarime publike në emër të organizatës që janë në kundërshtim me parimet dhe vlerat e organizatës

Neni 5 - Masat Disiplinore

- 5.1. Masat disiplinore që mund të shqiptohen për anëtarët që nuk respektojnë këtë rregullore:
 - a. Suspendimi nga 7 deri në 30 ditë dhe vërejtje me shkrim
 - b. Largimi nga pozita ose detyra
 - c. Largimi nga organizata
- 5.2. Masat disiplinore i shqipton Kuvendi i Anëtarëve me miratimin e shumicës prezent në mbledhje

Neni 6 – E drejta për Ankesë

- 6.1. Në rast se anëtari nuk pajtohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve, ai/ajo ankesën mund t'ia drejtoj ankesën mekanizmave të tjerë ligjor.

Neni 7 – Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Kjo rregullore është aprovuar në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Anëtarëve, Prishtinë, më 5 nëntor 2018.